



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

NR. REF _____/2019

KUVENDI I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.12 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenin 22, paragrafin 1 me nën-paragrafin 1.12 dhe 1.14 dhe Nenit 53, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.1 të Statutit të OMK-së dhe Nenit 23, paragrafit 2 të Rregullores për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OMK-së, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me 17 janar 2019, nxjerrë këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN TAKSAVE ADMINISTRATIVE

Taksat administrative për identifikim dhe regjistrim

- I. Të gjithë anëtarët e OMK-së për rrethanat e mëposhtme janë të obliguar që të paguajnë taksat administrative si në vijim:
 - I.I Taksa administrative për regjistrim në Regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, në shumë prej 5.00 (pesë) € (euro);
 - I.II Taksë administrative për reregjistrim në regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, në shumë prej 25 (njëzet e pesë) € (euro);
 - I.III Taksë administrative për reregjistrimin e dytë në anëtarësinë e OMK-së, në shumë prej 100.00 (njëqind) € (euro);
 - I.IV Taksë administrative për aplikim për ndërrim të kartelës për shkak të ndërrimit të statusit profesional, për shkak të humbjes apo dëmtimit të kartelës së anëtarësisë në OMK në shumë prej 2.00 (dy) € (euro);

Taksa administrative për Edukim Specialistik

- I. Të gjithë kandidatët që i nënshtrohen procesit të Edukimit Specialistik, obligohen që të bëjnë pagesën e taksave administrative si në vijim:
 - I.I Taksë administrative për aplikim për paraqitjen e provimit specialistik në shumë prej 10.00 (dhjetë) € (euro);
 - I.II Taksë administrative për provimin specialistik në shumë prej 180.00 (njëqind e tetëdhjetë) € (euro);
 - I.III Taksë administrative për Certifikatën e provimit specialistik në shumë prej 15.00 (pesëmbëdhjetë) € (euro);
 - I.IV Taksë administrative për Librezën e specializimit në shumë prej 20.00 (njëzet) € (euro);

Taksat administrative për licencim, rilicencim dhe vlerësim në EVP

- I. Anëtarët e OMK-së të cilët i parashtrojnë kërkesat e tyre për shqyrtim pranë organeve gjegjëse kompetente, janë të obliguar që të paguajnë taksat si në vijim:
 - I.II Taksë administrative për parashtrim të aplikacionit për valorizim të pikëve kredituese të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional në shumë prej 10.00 (dhjetë) € (euro);
 - I.II Taksa administrative për dhënie të Licencës së punës pas procesit të Rilicencimit , në shumë prej 40.00 (dyzet) € (euro) për kohëzgjatje prej 5 (pesë) viteve;
 - I.III Taksa administrative për dhënie të Licencës së punës, në shumë prej 50.00 (pesëdhjetë) € (euro) për kohëzgjatje prej 5 (pesë) viteve;
 - I.IV Taksa administrative për ekzemplarin e dublikuar të licencës së punës në shumë prej 15.00 (pesëmbëdhjetë) € (euro); dhe
 - I.V Taksa administrative për lëshim të faksimilit në shumë prej 15.00 (pesëmbëdhjetë) € (euro),
 - I.VI Taksa administrative për lëshim të faksimilit të dytë në shumë prej 10.00 (dhjetë) € (euro),

Taksat administrative në procedurat e mbikëqyrjes etike

- I. Taksat administrative që ndërlidhen me veprimtarinë e mbikëqyrjes etike, përcaktohen si në vijim:

I.I Taksa administrative për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj mjekëve në shumë prej 30.00 (tridhjetë) € (euro);

I.II Taksa administrative për lëshim të certifikatës për të kaluarën etike (“Certificate of good standing”), qoftë për nevoja brenda territorit të Republikës së Kosovës, qoftë jashtë vendit do të aplikohen taksat e përgjithshme për dokumentet që lëshohen sipas Nenit 8, paragrafit 1 me nënparagrafët I.I, I.II dhe I.III të këtij vendimi.

II. Palët të cilët janë të përfshirë në skemën e ndihmave sociale, do të lirohen nga pagesa e taksës për iniciim të procedurës disiplinore që është paraparë me nënparagrafin I.I të këtij neni.

Taksat e përgjithshme administrative

I. Për nevoja personale të anëtarëve të OMK-së lidhur me lëshimin e dokumenteve të ndryshme, përcaktohen taksat administrative si në vijim:

I.I Taksa administrative për dokumente dhe certifikata të lëshuara për përdorim brenda Republikës së Kosovës përveq vërtetimeve të anëtarisë, licencimit/rilicencimit në shumë prej 5 (pesë) € (euro);

I.II Taksa administrative për dokumente dhe certifikata të lëshuara për përdorim jashtë territorit të Republikës së Kosovës në shumë prej 25 (njëzet e pesë) € (euro); dhe

I.III Taksa administrative për dokumente dhe certifikata të lëshuara në gjuhën shqipe dhe angleze për përdorim jashtë territorit të Republikës së Kosovës në shumë prej 30 (dhjetë) € (euro);

Taksat administrative për dhënien e lejës për hulumtime bio-mjekësore

1. Aplikuesit për dhënien e lejit për hulumtime bio-mjekësore, persona fizik apo juridik, do të jenë të obliguar që të paguajnë taksën administrative si në vijim:

1.1 Për persona fizik (individët) qytetarë të Republikës së Kosovës anëtarë të Odës në shumë prej 100.00 (njëqind) € (euro);

1.2 Për persona fizik (individët) qytetarë të Republikës së Kosovës të cilët nuk janë anëtarë të Odës në shumë prej 350.00 (treqind e pesëdhjet) € (euro);

- 1.3 Për persona fizik (individët) qytetarë jo Kosovarë dhe të cilët nuk janë anëtarë të Odës në shumë prej 400.00 (katërqind) € (euro);
 - 1.4 Për persona juridik organizata joprofitabile të regjistruara në Republikën e Kosovës në shumë prej 150.00 (njëqind e pesëdhjetë) € (euro);
 - 1.5 Për persona juridik organizata profitabile të regjistruara në Republikën e Kosovës në shumë prej 400.00 (katërqind) € (euro); dhe
 - 1.6 Për persona juridik organizata ndërkombëtare që nuk janë të regjistruara në Republikën e Kosovës dhe nuk janë në marrëdhënje partneriteti me njësitë e Qeverisë së Kosovës në shumë prej 350.00 (treqind e pesëdhjetë) € (euro).
2. Organi kompetent i OMK-së i cili lejon hulumtimin, taksën administrative varësisht nga kategoria e përcaktuar me paragrafin 1 të këtij neni, do ta përcaktojë në aktin e lejimit.

Zbatimi i taksave administrative

Taska administrative për iniciimin e procedurës së valorizimit të pikëve kredituese për EVP nuk kthehet në rast të refuzimit të rilicencimit. Me rastin e dhënies së licencës, shuma e taksës së paguar për iniciim të procedurës për valorizimit të pikëve kredituese për EVP për procesin e rilicencimit do të llogaritet në totalin e taksës administrative për lëshim të licencës së punës.

Hyrja në fuqi

- I. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat që kanë përcaktuar lartësinë e taksave administrative në OMK.
- II. Taksat administrative lidhur me edukimin specialistik nga Neni 5 i këtij vendimi, do të jenë të zbatueshme pas bartjes së kompetencës mbi edukimin specialistik nga Ministria e Shëndetësisë tek OMK-ja.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i OMK-së..

Prishtinë, 17.01.2019

Kryetari i OMK-së
Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.sci